

Lef Nosi: “Dokumente Historike (1912-1918)”
SHTYPSHKRONJA “NËNË TEREZA”, TIRANË, 2007, 350 F.

Lef Nosi është një emër i njohur nga shqiptarët. Ai ishte një nga figurat kryesore që kontribuoi në organizmin dhe zhvillimin me sukses të Kongresit Arsimor Kombëtar të Elbasanit në tetor 1909. Ai është një protagonist i rëndësishëm në çeljen e shkollës normale të Elbasanit më 1 dhjetor 1909 që përgatiti gjenerata mësuesish për shkollat shqipe të vendit.

Në vitin 1912 Nosi u zgjodh Deputet i Elbasanit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe nënshkroi aktin e Pavarësisë Kombëtare⁶⁰³. Ai u zgjodh ministër i postave dhe i telegrafëve në Qeverinë e Përkohshme të Ismail Qemalit.

Nosi pati peshë në Elbasan edhe gjatë periudhës së Luftës së Parë Botërore. Ai nënshkroi, si përfaqësues i qytetit të Elbasanit, procesverbalin e arritur me bullgarët⁶⁰⁴. Nosi ishte më pas, anëtar i Qeverisë së Përkohshme të Durrësit me kryeministër Turhan pashë Përmetin⁶⁰⁵.

Në mbledhjen e Asamblesë Kombëtare më 20 tetor të vitit 1943, Lef Nosi u zgjodh me propozim të Xhaferr Devës, ministër i Brendshëm në qeverinë e Ibrahim Biçakut, anëtar i Këshillit të Regjencës⁶⁰⁶. Bashkë me të u zgjodhën në këtë Këshill edhe personalitete të rëndësishme të kohës, si: Mehdi bej Frashëri dhe Atë Anton Arapi. Të gjithë këta persona të propozuar nuk u lejuan të kundërshtonin propozimin. Emërimi në këtë detyrë shënoi fundin tragjik të Lef Nosit pas çlirimit të vendit. Ai dënua nga gjykata komuniste me vdekje me akuza të rënda si armik i popullit në gjyqin famëkeq të zhvilluar në Tiranë në shkurt të vitit 1946.

⁶⁰³ Shih vendimin e Shpalljes së Pavarësisë nga Kuvendi i Vlorës: Lef Nosi, *Dokumente historike (1912-1918)*, Tiranë, 2007, f.99.

⁶⁰⁴ *Po aty*, f.246-247.

⁶⁰⁵ O.Pearson, *Albania and the King Zog*, I, London, 2004, 117.

⁶⁰⁶ *Po aty*, II, f.290.

Në këtë gjyq Nosi nuk pranoi t'u përgjigjej pyetjeve që i drejtoheshin atij duke deklaruar se ishte i bindur se kjo ishte e pavlefshme në një gjyq komunist që tentonte likuidimin me forcë të kundërshtarëve të vet politikë⁶⁰⁷.

Lef Nosi ka lënë një trashëgimi të pasur në veprimtarinë e tij të gjerë në fushën e kulturës që ruhet në fondet e Arkivit Qendror të Shtetit.

Një vend të rëndësishëm në veprimtarinë patriotike të tij zë botimi i titulluar: *Dokumente Historike për t'i shërbyer Historisë tonë Kombëtare*. Këto materiale Nosi i botoi në fletore të përmuajshme duke filluar nga muaji mars i vitit 1924 deri në muajin shkurt të vitit 1925.

Në këtë botim përfshiheshin dokumente që lidheshin me ngjarje të historisë politike të vendit gjatë Luftërave Ballkanike, Shpalljes së Pavarësisë dhe Luftës I Botërore.

Qëllimi i botimit të këtyre dokumenteve, shkruante Nosi, ishte “*me qitë në dritë ngjarje*” që karakterizonin faza të ndryshme të evolucionit politik të Shqipërisë.

Dokumentet e botuara ishin të një rëndësie të jashtëzakonshme për vendin. Autori tregon edhe si kishte mundur t'i siguronte ato. Për këtë Nosi shkruan: “*Rastet e mira dhe kujdesi që kam pasun u bënë shkak me futë në dorë një numër të madh dokumentesh, të cilat janë një visar i paçmueshëm i Rilindjes sonë Kombëtare. Nga frika, se po të mos botohen me kohë mund edhe të humbasin, vendosa me i qitë në dritë, me anë të kësaj fletorje të përmuajshme*”⁶⁰⁸.

Dokumentet e grumbulluara ishin të shkruara në gjuhë të ndryshme; pjesën më të madhe e zinin dokumentet në gjuhë turke. Nosi u shtrëngua t'i përkthente këto për botim në gjuhën shqipe, duke lënë për më vonë botimin e dokumenteve në gjuhë të huaja. Lef Nosi shkruan se ndërmori këtë botim për të evituar manipulimin e historisë.

“*Shumë ngjarje të kohës së shkueme-shkruan ai, kanë ngelë vetëm në mendje të popullit, edhe në mos i shkrofshin me kohë, mund të harrohen fare ose të ndryshohen, për me i qitë në dritë, do të botojmë gjithnjë në fund të fletores disa faqe të posaçme me titullin : Kujtime*”⁶⁰⁹.

Autori tregon kriteret e botimit, të cilat i paraqiti në një faqe të titulluar “*Shënime*”⁶¹⁰.

Botimi i Nosit pavarësisht nga dobësitë e veta të kuptueshme⁶¹¹ luajti një rol të rëndësishëm për historianët, sepse u dha atyre dokumente

⁶⁰⁷ Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, Tiranë, 2008.

⁶⁰⁸ Lef Nosi. *Dokumente historike ...*, parathënie.

⁶⁰⁹ *Po aty*.

⁶¹⁰ *Po aty*.

për ngjarje të rëndësishme të historisë së Shqipërisë, siç ishte sidomos Shpallja e Pavarësisë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës më 28 nëntor 1912.

Instituti i Historisë, duke konstatuar vlerën historike të dokumenteve të botuara nga Nosit, vendosi ribotimin e tyre në një vëllim më vete të titulluar “*Lef Nosi, Dokumente Historike (1912-1918)*”, Tiranë 2007. Ky botim u bë me rastin e 95-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Me përgatitjen për botim dhe redaktimin shkencor të këtij botimi u morën prof. M.Verli dhe prof. F.Duka.

Në botim është respektuar kriteri tematik dhe rendi kronologjik i materialeve. Autorët kanë dhënë shpjegime përkatëse për terma të pakuptueshme për lexuesin e sotëm.

Botimi i Institutit të Historisë i ka qëndruar besnik nga ana gjuhësore botimit të vjetër të Nosit. Prof. Duka shpjegon se ky qëndrim ka ndodhur meqenëse Instituti dhe ata nuk patën në dorë dokumentet në gjuhë origjinale që pati Nosi. Në këto rrethana botimi i Institutit nuk mund të bëhej ndryshe, veçse “në variantin gjuhësor të kohës kur kanë dalë në dritë”⁶¹².

Botimi i Institutit është një shërbim me vlerë për historiografinë shqiptare. Me rëndësi është të theksohet se ky botim shoqërohet edhe me një indeks të emrave të personave dhe vendeve.

Dokumentet janë botuar në kapituj të ndryshëm të librit. Dokumentet e para janë përfshirë në kapitullin e titulluar “*Veprime ushtarake të luftës Ballkanike më 1912*”.

Pjesa më e madhe janë telegrame që dërgonin midis tyre komandantë të forcave të armatosura të Perandorisë Osmane gjatë Luftës I Ballkanike. Këto janë urdhra të Komandës së Përgjithshme të Kufirit të Malit të Zi, si dhe telegrame të prefektëve dhe nënprefektëve dërguar kësaj administrate. Në to ka të dhëna mbi gjendjen ushtarake të trupave, numrin e të vrarëve dhe të plagosurve, përplasjet ushtarake me armikun, pajisjet ushtarake të trupave, mungesat e konstatuara në drejtim të armatimit, veshjeve, ushqimit, urdhra për lëvizjen e trupave në mbrojtje të Shkodrës etj.

⁶¹¹ Një nga të metat e rëndësishme e vë në dukje z. Ferit Duka. “Materialet e botuara nga Nosi - shkruan ai, ishin dhënë të copëtuara në pjesë të ndryshme duke e shtrirë të njëjtin dokument në të gjithë numrat e serisë”. Lef Nosi, *Dokumente historike...*, parathënie.

⁶¹² K. Dervishi, *vep. e përm.*

Në këto materiale flitet pak për shqiptarët. Për to flitet në telegramin e dërguar Komandës së Fuqive të Përgjithshme të Kufirit të Malit të Zi nga nënprefekti i Tiranës. *“Disa prej Parisë së vendit-shkruante ai, duan të marrin inisjativën për të gatitë dhe dërguar një fuqi në Shkodrës për ndihmë. Por, pasi këtu armë nuk ka, të dërgohen 1000 prej andejë”*⁶¹³. Siç kuptohet nga këto rreshta, shqiptarët ishin vënë në lëvizje nga krerët e vendit për të dërguar vullnetarë në mbrojtje të Shkodrës, që rrezikohej të pushtohej nga malazezët.

Në libër janë botuar materiale të tjera në kapitullin e titulluar: *Proklamimi i Indipendencës Shqiptare më 1912. Qeveria e Përkohëshme e Vlonës. Telegrame.*

Këto dokumente hapen me një telegram të nisur nga Vjena nga Ismail Qemali, më 27 Vjeshtë e Dytë 1328-1912. Në këtë telegram të rëndësishëm të kohës, Ismail Qemali shënon: *“Me vaporrin e parë po mbërrinj. E ardhmja e Shqipnisë asht sigurie. Ju porosis qi tyke i umbështetun fatit t’atdheut të punoni së bashku e si vllazën, të merreni me rregullimin e punëvet të përgjithshme, edhe të ruani qetësinë. I epni rrethetvet lajmin e gëzueshme. Ju falem të gjithëve atënisht. Ismail Qemali.”*⁶¹⁴

Kjo seri dokumentesh është me rëndësi të veçantë për Historinë e Shqipërisë, sepse ka të dhëna interesante për Shpalljen e Pavarësisë nga patriotët shqiptarë.

Vëllimi përmban si kapitull më vete *“Vendimet e Kuvendit Kombëtar të Vlonës”*⁶¹⁵. Këtu përfshihen materialet e shtatë vendimeve të Kuvendit. Nga materialet rezulton se mbledhja e parë është bërë në shtëpinë e Xhemil Beut më 15-28 të Vjeshtës së Tretë 1912. Këtë mbledhje e hapi Ismail Qemali, i cili u tregoi *“delegatëve qëllimin e Kuvendit, do me thënë të përpiqen së bashku të merrnin masat e nevojëshme për të shpëtuar Shqiptarinë nga rreziku i madh ku ndodhet sot.”*⁶¹⁶

Në këtë pjesë shënohen emrat e delegatëve të Kuvendit të Vlorës, ku përfshihen edhe katër delegatë të caktuar nga Kolonia e Shqiptarëve të Bukureshtit. Meqenëse Shkodra ndodhej nën pushtim malazez, në

⁶¹³ Lef Nosi, *Dokumente historike ...*, f.24.

⁶¹⁴ *Po aty*, f.69.

⁶¹⁵ *Po aty*, f.176-186.

⁶¹⁶ *Po aty*, f.176.

mbledhje u zgjodh si delegat i Shkodrës, Luigj Gurakuqi, i cili, siç thuhet në këto dokumente “*ishte një nga iniciatorët e mbledhjes*” së Kuvendit.

Kuvendi zgjodhi si kryetar Ismail Qemalin, si “*shkrojës të parë*” Luigj Gurakuqin dhe si shkronjë të dytë, delegatin e Elbasanit Shefqet Be Daiu. Në fjalën që mbajti në mbledhje Ismail Qemali tha :

*“Shqiptarët ndonëse besnikë kurdoherë të Mbretërisë Othomane, nuk e kanë harruar kurrë as gjuhën as kombësinë e tyre e prova më e mirë janë përpjekjet e kryengritjet që bënë herë pas here e sidomos në këto katër vjetët e mbramë për të ruajtun të drejtat e zakonit e veta. Qeveria Othomane nuk e vështroi kurrë inderreshtin e saj e nuk deshë kurrë t’ua shpërblenjë me të mirë Shqipëtarëvët shërbimet e mëdha që i kanë”*⁶¹⁷.

Ismail Qemali tregon më tej se shqiptarët u vunë në lëvizje kur shpërtheu Lufta Ballkanike, kur ushtria osmane u mund dhe Mbretëria nuk mund të qëndronte më. Mbasi tregon takimet në kancelaritë e vendeve të ndryshme të Evropës ku ai bisedoi për çështjen shqiptare, Ismail Qemali deklaroi se “*e vetmja udhë shpëtimi (për vendin) ishte ndarja e Shqipërisë nga Turqia*”.⁶¹⁸

Ismail Qemali tërhoqte vëmendjen për masat që duheshin marrë me qëllim që “*të bahet Shqipëria më vehte nën një Qeveri të Përkohshme: të zgjidhet një Pleqësi për ndihmë e kontroll Qeverisë, të dërgohej një komision në Europë për të mbrojtur çështjen shqiptare përpara Mbretërive të mëdha*”.

Pasi dëgjuan fjalët e Ismail Qemalit, delegatët vendosën që “*Shqipëria të bahet që sot më vehte e lirë e e mosvarme nën një qeveri të përkohëshme*”⁶¹⁹.

Në mbledhje u zgjodh “*Kryetari i Qeverisë së përkohshme*” Ismail Kemal Beu dhe nënkryetar Dom Nikoll Kaçorri. Pas këtij vendimi historik, delegatët “*dualën jashtë (në ballkon) të përshëndetin flamurin që u ngrit në orën 5 e gjysëm pas dreke*”⁶²⁰

Në libër një kapitull tjetër me dokumenta titullohet: *Kryengritja kundër Princ Vidit më 1914*⁶²¹. Një vend të rëndësishëm këtu zënë “*Nyjet e Lidhjes qi u bisedue edhe u pranue në Krua*”. Këto 20 nyje apo

⁶¹⁷ Po aty, f.178.

⁶¹⁸ Po aty.

⁶¹⁹ Po aty.

⁶²⁰ Po aty.

⁶²¹ Po aty, f.187-241.

nene, siç i themi sot, ishin bërë “*në kohë të kryengritjes kundër regjimit të Wiedit*”. Këto nyje përfshinin detyrat kryesore të “Këshillavet Administratore” të vendit. Këto “nyje” tentonin që Shqipëria t’i aneksohej shtetit osman dhe nëse kjo do të rezultonte e pamundur, atëherë të kërkohej që në fron të Shqipërisë të hipte një mbret osman, apo, siç thuhet në dokument “*një mbret nga barku i Ali Osmanit*”.

Një dokument i rëndësishëm është telegrami i dërguar nga Komandanti i Fuqive të Përgjithshme Qamil Musa, me të cilin shpreh pakënaqësinë e tij për pushtimin e Vlorës nga kryengritësit. Në këtë telegram, Qamil Musa vendosi “kushtet” që duhet të zbatoheshin nga ushtria kryengritëse.⁶²²

Një dokument i rëndësishëm është telegrami i dërguar nga Kryetari i Qendrës së Përgjithshme Mustafa Ndroqi, Kryesisë së Qendrës së Përgjithshme në Shijak. Ndroqi jep aty udhëzime për masat që duheshin marrë pas largimit të Wiedit dhe hyrjes së forcave kryengritëse në Durrës “*E ikmja e Princ Wiedit nga Durrsi - shkruan Ndroqi, të Martën qi vjen asht e sigurtë. Kini mendjen edhe mundohuni më i gjetë mënyrën që të hyhet në Durrës me urti, edhe qeverimi të mos hyjë në dorë t’Europës e të Komisionit të Kontrollit edhe popullin të mos e mundoni. Për qeveri formoni një Këshill edhe në kryesi të saj gjer sa të vij un emnoni Imam Hysni Efendine*”⁶²³.

Materialet tregojnë se kryengritja e fshatarësisë së Shqipërisë së Mesme zhvillohej në një situatë të rëndë ekonomike. Në vend kishin shpërthyer grabitjet.⁶²⁴ Hajdutë të veshur si gra grabitnin në fshatra bagëtinë e popullit.

Në vëllim është përfshirë edhe një letër drejtuar “Të Naltës Kryesi të Xhemietit Muhamedan Ottoman” në Elbasan, nga dy gra të quajtura Ganime dhe Saliha më 20 gusht 1914. Letra tregon gjendjen e vështirë ekonomike të vendit. “*Jemi nga Bihlisha e Korçës-shkruanin ata. Kur u shkel vendi ynë prej Greqisë ikëm e erdhëm n’Elbasan. Burrat tonë të quajtur Alush e Besim disa ditë më parë vdiqën prej zotit. Kemi mbetun të huaja e pa njeri me dy foshnje. Pasi këtu nuk kemi njeri që të na ushqejë, lutemi të kini mëshirë me na lëshue nga burgu Demir Eminin që ash fis i ynë ma i afërt..për me na lehtësue rrojtjen e me na ushqye*”⁶²⁵.

⁶²² *Po aty*, f. 212.

⁶²³ *Po aty*, f. 210.

⁶²⁴ *Po aty*, f. 221.

⁶²⁵ *Po aty*, f. 215.

Nga ngjarjet vlen të përmendet telegrami i datës 24 gusht 1914 që bën fjalë për “*cermenonitë e urimeve për pushtimin e Durrësit*” të kryera nga kryengritësit. Në shenjë gëzimi atë ditë në kala u shti me topa dhe u “*bë një gëzim i madh*”. Dokumentet shënojnë se “*u këndua Mevludi i Shenjtë edhe një Hatm i Shenjtë*” si dhe u bënë lutje “*për vazhdimin e suksesëve të luftëtarëve t’Islamizmës*”.⁶²⁶ Nga materialet rezulton se krerët e rebelëve urrenin shqiponjën dy krenare. Këtë kuptim kishte telegrami i dërguar nga Kryetari i Qendrës së Përgjithshme të Durrësit, Mustafa Ndroqi, Kryesisë së Këshillit Vlorë.

*“Ju baj me ditë-shkruante ai, se pullat e Dette Publique që janë vulosë me shqiponjë, të mos përdoren gjer sa të çoni e të merrni këndeje pulla të pavulosuna me vulën e këtij zogu të prapë”*⁶²⁷

Në libër ka të dhëna që tregojnë zhvillimin që po merrnin ngjarjet në Shqipëri në kohën e rebelimit “*Qëllimi ynë kryesor-shkruan Mustafa Ndroqi, ka qenë shpallja e Osmanllëkut dhe bashkimi me Mbretërinë Ottomane*”. Sipas tij, përpjekjet e lëvizjes synonin që “*Kombi shqiptar të futet e të hyjë prap ndën hijen e Mbretënis së përjetëshme Ottomane e të Naltit e të Madhnueshmit Halif*”⁶²⁸. Në vëllim përfshihen edhe dokumente të tjera interesante që tregojnë se në kohën kur Shqipëria u zhyt në kryengritjen e vitit 1914, grekët shtuan përpjekjet për pushtimin me forcë të tokave shqiptarë të Shqipërisë së Jugut të quajtura prej tyre “*Vorio-Epir*”.

Në vëllim ka të dhëna për djegiet që bënë grekët në fshatrat e Skraparit. Në një telegramin dërguar Kryetarit të Këshillit të Beratit, Haxhi Sheh Qerim Efendiut nga Zëvendëskryetar i Këshillës, Haxhi Demiri, datë 12 Vjeshtë e Parë 1330-1914, thuhet këto fjalë :

*“Komitat e Epirit kanë mësyë përsëri edhe përpjekjet vazhdojnë pa pushim. Kanë djegë katundet e Skraparit : Kapinovën, Gostnickën edhe katundet rreth tyre, ashtu edhe dje kanë djegë katundin Gjokovica të Tomoricës dhe lufta vazhdon në malet e katundit Barci edhe t’ikunit qi ndodheshin n’atë anë janë varë për fund të Lumit të Tomoricës... Epirotët po i vazhdojnë të mësymet n’anë të Skraparit e të Tomoricës, duket se do të shkaktohet shkulja e popullit t’asaj ane përsëri”*⁶²⁹ Për sulmet e grekëve bëhet fjalë edhe në dokumente të tjera. Në një dokument thuhet

⁶²⁶ *Po aty*, f. 215-216.

⁶²⁷ *Po aty*, f. 217.

⁶²⁸ *Po aty*, f.232.

⁶²⁹ *Po aty*, f.235.

këto fjalë: “*Të mësymet e Epirotëve na idhnuan edhe jemi duke u marrë me masat që të sigurohen e të ruhen kufijt edhe t’i epet fund të mësymëvet të tyre. U vendos që të dërgohet për së shpejti ushtria e nevojshme*”⁶³⁰.

Në vëllim ka proklamatë të bërë nga serbet gjatë okupacionit serb 1915, si dhe një proklamatë të Prenk Bib Dodës, Seid Pashës, Aqif pashë Elbasanit, Fejzi Bej Alizotit, Luigj Gurakuqit, me anë të cilës i bënin thirrje popullit për të qëndruar në anë të Mbretërisë Austro-Hungareze.

Në vëllim ka dokumente që shënojnë hyrjen e ushtrisë Bullgare në Elbasan. Aty përfshihet edhe procesverbali i arritur në Elbasan midis bullgarëve dhe përfaqësuesit të qytetit, Lef Nosi⁶³¹.

Në vëllim ka disa dokumente që bëjnë të ditur përpjekjet e Ahmet Zogut dhe të një grupi politikanësh për mbajtjen e një “Kongresi Kombëtar” në Elbasan në vitin 1916. Ky kongres duhej të merrte vendime të rëndësishme për qeverisjen e vendit në periudhën e vështirë të pushtimit të huaj. Me këtë rast Ahmet Zogu lëshoi disa thirrje drejtuar personaliteteve të ndryshme, për të marrë pjesë në këtë kongres si delegatë të krahinave të tyre.

Në libër ka edhe dokumente që mbajnë titullin “*Okupacioni Italian*”⁶³².

Me rëndësi këtu është Proklama e Gjirokastrës e datës 3 qershor 1917, më të cilën komandanti i trupave italiane Gjeneral G.Ferrero proklamonte “bashkimin e independencës të të gjithë Shqipniës” nën mprojtjen e Mbretërisë Italiane⁶³³.

Proklama u kujtonte shqiptarëve lidhjet historike të Italisë me Shqipërinë që nga periudha romake dhe ajo veneciane. Ajo bënte thirrje atyre që të “*bashkoheshin nën hijen e flamurëve italianë “për një Shqipëri independente, me miqësinë e mbrojtjen e Italisë*”⁶³⁴

Libri ka disa dokumente të titulluara “*Kongresi i Tiranës*”. Me rëndësi është këtu një dokument i datës “8 Shindre” 1918 i Bashkisë së Tiranës, që i kërkonte Bashkisë së Elbasanit të dërgonte në Tiranë dy përfaqësues. Këta do të vinin nga çdo rreth në një mbledhje në Tiranë, për të “*siguruar bashkimin e njisin e Kombit dhe me pre propogandat e huaja*”. Mbledhja do të mbahej më 19.XII.1918. Dokumentet tregojnë se

⁶³⁰ *Po aty*, f.236.

⁶³¹ *Po aty*, 246-247.

⁶³² *Po aty*, f. 276-283.

⁶³³ *Po aty*, f.276.

⁶³⁴ *Po aty*, f.277.

delegatët e qarqeve Tiranë, Krujë, Kavajë, Peqin, Mat u mbledhën në këtë datë në Bashkinë e Tiranës. Aty u zgjodh kryetar Abdi bej Toptani dhe sekretar Xhemal Belegu. Ky Komitet, i cili kishte edhe anëtarë të tjerë të zgjedhur, vendosi më datën 20.12 1918, mbledhjen e një kongresi kombëtar me delegatë nga gjithë vendi me datë 11.1.1919.

Komiteti vendosi që kongresi të mbledhej në Krujë meqenëse ky kishte ngarkesat e duhura emocionale të një “qytet historik” *“Mbledhja e Përgjithshme”* në Krujë duhej të arrinte *“formimin e një kabineti të përgjithshëm”*, i cili të përfaqësonte Shqipërinë dhe të mbronte të drejtat dhe interesat kombëtare para Konferencës së Paqes në Paris. Kongresi do të zgjidhte delegatët që do të dërgoheshin atje.⁶³⁵ Libri ka dokumente që janë futur në kapitullin *“Kongresi i Durrësit”*. Ky kongres filloi më 25 dhjetor 1918 në prani të delegatëve të ardhur nga gjithë vendi. Materialet e botuara në këtë kapitull dëshmojnë se Organizatorë të këtij kongresi ishin Myfit Bej Libohova dhe Mehmet Bej Konica. Kongresin e hapi Myfit Bej Libohova. Në vend të Konicës që ishte i sëmurë të zgjidhej si nënkryetar Fejzi Bej Alizoti. Hiqmet Delvina propozoi që të zgjidhej si nënkryetar edhe Pjetër Poga me qëllim që të kishte edhe një lab në kryesinë ku ishin të gjithë toskë. Më pas e mori fjalën K.Gurakuqi. Ai e pranoi kandidaturën e propozuar por tha se ishte *“kundër që në një mbledhje kombëtare si kjo, të përmenden fjalët Tokës e Gegë, të krishterë e myslimanë”*⁶³⁶. Si sekretar i kongresit u zgjodh Mustafa Kruja.

Në mbledhje e parë, më datë 25 dhjetor 1918, delegatët deklaruan *“gazmendin e pasosun të saj tue pamë se Kombi ynë mbërrini sot me anën e përfaqësuesvet të vet t’i tregojë bujënisht botës dëshirën e vullnetin e patundshëm për t’u dalë zot me të tana mënyrat të drejtavet të pahumëshme të Shqiptarisë”*⁶³⁷.

Në mbledhje Karl Gurakuqi propozoi që t’i dërgohej një telegram mirënjohjeje *“të madhit qytetar amerikan Wilson”*, i cili shpalli parimin e *“vetëvendimit”* të popujve, si dhe senatorit amerikan z.Lodge, i cili kishte thënë se një nga themelet mbi të cilat do të vendoset Paqa e Përgjithshme do të ishte që edhe Shqipërisë t’i bashkohen të gjitha ato vise ku flitej gjuha shqipe e rronte kombi shqiptar⁶³⁸.

⁶³⁵ Po aty, f.283-287.

⁶³⁶ Po aty, f.289.

⁶³⁷ Po aty, f.290.

⁶³⁸ Po aty, f.291.

Mbledhja miratoi formimin e një Qeverie të Përkohshme. Si kryetar i qeverisë u zgjodh Turhan Pasha dhe nënkryetar Preng Bib Dodë Pasha. Anëtar të qeverisë u zgjodhën Sami Bej Vrioni, Imzot Luigj Bumci, Myfit Bej Libohova, Dr.M.Turtulli, Mehmet Bej Konica, Luigj Gurakuqi, Mithat Bej Frashëri, Lef Nosi, Fejzi Alizoti, Mehmet Bej Frashëri, Pjetër Poga, Mustafa Kruja.

Nga këta pjesëtarë, disa do të shkonin bashkë me Turhan Pashës si kryetar, në Paris për të mbrojtur të drejtat e Shqipërisë në Konferencën e Paqës.

Materialet e botuara në këtë vëllim tregojnë se në këtë mbledhje e mori fjalën edhe Polo Mjekshi, i cili porosi “*vllaznimin e bashkimit në mes të shqiptarëve pa ndryshim feje e fisi*”. Në libër jepen edhe vendimet të tjera që mori Kongresi i Durrësit më 26 dhe 27 dhjetor lidhur me Pleqësinë, si organ për të kontrolluar Qeverinë e Përkohshme.

Me rëndësi është të përmendim propozimin e Mustafa Krujës për zgjidhjen e Shkodrës, kryeqytet të Shqipërisë⁶³⁹. Këtu është botuar edhe një letër dërguar nga Aqif Pasha Elbasani drejtuar “Kryetarit të ndershëm të Mbledhjes Shqiptare” në Durrës ku propozon t’i qëndrohet vendimit të Konferencës së Londrës për formën e qeverisjes.

Në libër ka edhe “*Kujtime të kryengritjes së viti 1914*”⁶⁴⁰, të cilat janë marrë nga Thanas Floqi. Kujtimet ndihmojnë për të njohur figurën e Haxhi Qamilit, konceptet e tij të prapambetura dhe antishqiptare për të ardhmen e Shqipërisë, dhunën dhe terrorin që ushtroi në Shqipëri dhe emrat e nacionalistëve shqiptarë të vrarë e të burgosur prej rebelëve.

Duke përfunduar paraqitjen e këtij botimi të rëndësishëm të ndërmarrë nga Instituti i Historisë e shohim me vend të bëjmë një vërejtje. Dokumentet nuk kanë numër në botimin e Nosit dhe po kështu edhe në botimin e Institutit. Kjo detyron studiuesit të citojnë faqen ku ndodhet dokumenti. Ky citim nuk është i saktë sepse në një faqe mund të ketë më shumë se një dokument. Në këtë rast mund të kishte qenë me vend vendosja e numrave të dokumenteve.

Luan MALLTEZI

⁶³⁹ *Po aty*, f. 296.

⁶⁴⁰ *Po aty*, f.302-327.